


PRIMARSCHULE UNTERENGSTRINGEN



PRIMARSCHULE UNTERENGSTRINGEN



Maja Noser
Schulsozialarbeiterin

Wo Schulhaus Büel A im Erdgeschoss

Wann Montag 08:00-12:00 und 13:00-16:00 Uhr
Dienstag 08:00-12:00 und 13:00-16:00 Uhr
Donnerstag 08:00-12:00 und 13:00-16:00 Uhr

Erreichbarkeit Handy 079 505 79 95
Festnetz 044 752 20 64
E-Mail schulsozialarbeit@ps-buel.ch

Schulsozialarbeit Ein Angebot im Lebensraum Schule

Information für Eltern



Çka është puna sociale e shkollës dhe kujt i drejtohet?

Puna sociale e shkollës është një ofertë për këshillat dhe mbështetjen e nxënësve dhe nxënësve, prindërve, mësuesve dhe shkollës.

Nxënësit dhe nxënëset do të marrin ndihmë dhe mbështetje të shpejtë dhe pa komplikime. Për frikën, shqetësimet, polemikën ose pyetje në lidhje me bashkëjetesën ata mund të individualisht (vetëm) ose në grupe të marrin këshillat tek puna sociale e shkollës. Kjo ka të bëjë me atë që sakt ta shiqojmë situatën dhe së bashku ta kërkojmë zgjidhjen.

Prindërit mund të kontaktojnë me punën sociale të shkollës, nëse janë të brengosur për zhvillimin e fëmijës së tyre ose nëse i shqetëson ndonjë situatë tjetër në shkollë. Puna sociale e shkollës mund të ndihmojë, të qartësojë, ajo është e njohur me shumë pyetje lidhur me zhvillim dhe shkolim, dhe i njehë agjencionet profesionale përkatëse.

Mësuesit mund të diskutojnë me punën sociale të shkollës, për situatat të vështira qoftë një individ apo ndonjë grupi. Poashtu problemet do të trajtohen dhe zgjidhen së bashku.

Për tërë shkollën apo për klasët në veçanti mundet puna sociale e shkollës të inkurajojë apo të përcjell projektet ose aktivitetet e ndryshme.

Si punon puna sociale e shkollës?

Puna sociale e shkollës është prezente në shkollë, ka orarin e punës të fiksuar apo është e arritshme në telefon. Marrja e kontaktit është e thjeshtë.

Këshilla individuale zakonisht është vullnetare. Një këshillë fillestare mund të iniciohet edhe nga mësuesi.

Oferta është e besueshme (sekrete). Punëtorët ose punëtorët sociale të shkollës janë të obliguar si subjekt ta mbajnë sekretin profesional.

Shërbimet janë falas.

Kur mund të drejtohen prindërit punës sociale të shkollës?

Nëse ata janë të brengosur për zhvillimin e fëmijës së tyre, ose janë të shqetësuar për ndonjë situatë tjetër.

Më mirë më heret se sa më vonë!

Më mirë njëherë më shumë, se sa një herë më pak!

Nuk do të thotë se çdo herë kemi ndonjë krizë (problem) të madhe, nëse edhe puna sociale e shkollës është ftuar të marrë pjesë!

Për këshilla në gjuhën tuaj keni të drejtë të kërkonit përkthyes.